



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ 396

Datë: 12.10.2018

Procesverbal  
i mbledhjes se IV ( katërt ) të Komitetit për Politikë dhe Financa

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor i punës për vitin 2018 i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
3. Shqyrtimi i raportit të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Buxhetit për vitin 2019-2021.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2019.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1319 datë: 14.09.2018 për iniciimin e procedurave administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllime të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe biznesore private.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për periudhën Janar-Shtator 2018.
8. Debat rreth raporteve të bashkëpunimit të Qeverisë Komunale dhe Kuvendit të Komunës.
9. Emërimi i tre anëtarëve të Komitetit për Barazi Gjinore.
10. Emërimi i tre anëtarëve të Komisionit për banesat e 32 familjeve në Lagjen Mirditë në Malishevë.
11. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/333 datë: 10.09.2018 e parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirë të Luftës.
12. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/334 datë: 10.09.2018 e parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirë të Luftës.
13. Shqyrtimi i kërkesave.
14. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 18.09.2018, filloj në ora 10, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, përfaqësuesi i OSBE-se, zyra për informim, qytetar.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve e kemi thirrë mbledhjen e IV të jashtëzakonshme, sepse Qeveria Komunale është vonuar në përgatitjen e projekt buxhetit e qe në Kuvend projekt buxheti bëhet në dy lexime. A keni diçka rreth rendit të ditës?

Raimonda Krasniqi: Për pikat nga mbledhja e kaluar ska nevojë debat.

Rahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin të gjithë për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rahim Morina: Kush jeni për miratimin e këtij procesverbalit? Nga 4 te pranishëm unanimisht ishin për.

Rahim Morina: Pika 2 dhe 3 veç janë përsëritur nga mbledhja e kaluar, kush jeni që të rekomandohen prapë për mbledhje të Kuvendit? Unanimisht ishin për 5 anëtarët e KPF.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Buxhetit për vitin 2019-2021.

Hashim Vrenezi: Ne si grup i kemi bërë analizë këtij projekt buxheti kemi, kam shumë vërejtje, te specifikohen investimet me saktësi si kanalizime sa metra dhe ne cilat fshatra. Thuhet në fshatin Terpezë por në cilat lagje dhe sa metra, ose në fshatin Drenovc 2000 metra por ku. Objekti i banimit social qe është miratuar të ndërtohet, në Kuvend neve na është thënë se është projekt i Ministrisë tani prapë ceket që Komuna ka me nda mjetë, por a edhe për grante qeveritare Komuna ndanë mjete, pse me kanë pjesë e buxhetit ose me shkru si bashkëfinancim?

Në sektorin e bujqësisë 400 mijë euro në cilat lloje të projekteve apo prapë kanë mu shpërnda nëpër partiak të vet, për ujësjellësit në tri fshatra 120 mijë euro për vitin 2018 kanë qenë te parapara fshati Marali e që s'kemi ujë, fshatin Pagarushë, Llapçevë dhe Bardh, por te kryhen këto fshatra njëherë e pastaj te futen tjerat. Ndriçimi publik është më i specifikuar por në Pagarushë nuk specifikohen dhe cilat lagje. Është folë për kanalizime e në pjesën tjetër s'dihet a janë rrugë 1500 m me asfalt, kubza apo çka. Cilat rrugë kanë mu mirëmbajt në vitin 2019, cilat rrugë janë parapare me kubza, ceket rregullimi i parkut por që ska nevojë aq shumë investim. Më mirë është te rregullohet parku në Mirushë se ka nevojë, ka projekte që s'janë filluar ose që kanë filluar e spo kryhen si duhet. Renovimi i Mullirit në Banjë dhe Kulla në Llapçevë kërkoj të dijë se në Banjë me duket është investu. Në lexim të parë të behët analizë nga gjithë ne dhe të behet një ridestininim në projekte tjera.

Alban Krasniqi: Ju përshëndes këtij projekt buxheti i kanë paraprirë disa takime e që s'kanë pas efekt substancial në planifikimin buxhetor. Çka shihet si përparësi e kanë bërë një përshkrim pak me të detajuar në investime kapitale edhe pse dikun a përmend lagja dikund rruga, projekt buxheti të shikohet aty ku ka nevojë pra orientimi buxhetor mungon. Duhet mu koncentru në nevoja bazike në objektiva e aktivitete buxhetore e mos mu shpenzuar qysh është shpenzuar deri me tani pra qasja afatgjate mungon.

Kërkoj me ditë a ka reflektuar ndarja nga Kuvendi e 100 eurove për secilin fëmijë te porsalindur, pastaj shujtat për nxënës a do te përfshihen. Shëndetësia të përfshihet në buxhet nëse ka projekte të dihet sa punëtor ka ose ku ka ndonjë nevojë për zëvendësime, cila është struktura e ndryshimit brenda përshëmbull në punëtor sikur që kemi bërë në KAB. Ne si subjekte kërkoj t'i bëjmë një analizë këtij projekt buxheti në prioritete dhe atyre që duhet të përfshihen. S'kemi një raport të gjendjes infrastrukture në asnjë fshat, sa shtëpi duhet ndërtohen për nevojtarët, pastaj ka nevoja tjera që duhet mu plotësuar. Mos realizimin e buxhetit ja atribuojnë të hyrave vetanake dhe buxhetit të konsoliduar. Ka ardh një buxhet pa prezencën e drejtorëve në mbledhje e kjo tregon që z. Begaj spo na bën hesap, e tash ne a ta bëjmë hesap z. Begaj ose qytetarin pra t'i marrim për bazë nevojat e qytetarëve. Orientimet t'i përcaktojmë ne ose me vazhdu sikur deri tani, por ne mund te ju prishim disa pazare klienteliste.

Rrahim Morina: Në projekt buxhet duhet të specifikohen lagjet cilat janë ato dy standarde jo dikun Komuna i përfshin projektet për lagje dikund qytetaret obligohen vet mi rregulluar problemet që i kanë. Duhet një analizë e projekt buxhetit, atje ku ka ndodhë masakra e Burimit të rregullohet rruga që qon deri aty.

Alban Krasniqi: Të Komitetet e pash që përgjysmë e kanë nda punën, nuk e kanë caktu sa mbledhje mu mbajte e jo me thanë veç tri mbledhje.

Kastriot Berisha: Nëse ne kemi mendim te mirë në këtë projekt buxhet besoj se edhe punën e bëjmë të mirë, në fshatin Gurëbardh te vrella ska kanalizim sepse nuk janë me Nismën, kanalizimi i Burimit dhe Gurëbardhit derdhen në mes të livadheve e tash ne mundem me ba një buxhet për lakmi. Ka nevojë për disa rrugë mu shtru, minitransiti a bërë lugje krejt e ne pushtetin mundem me sulmu veç me fakte.

Valon Krasniqi: Ka gabime sidomos të rrugët nuk specifikohen ne duhet këtë temë me diskutuar, të bëhet një komision me shku neper fshatra me pa ku jetojnë. Ka fshatra që nuk kanë nevojë për investime në krahasim me fshatrat tjera që kanë nevojë, ka që ende s'kanë fusha të sportit.

Raimonda Krasniqi: Ne si grup i PDK kemi shqyrtuar ka projekte që vazhdojnë që disa vite kanalizimi në fshatin Terpezë veç për tri shtëpi e pastaj aj kanalizim del mbi shtëpi të disa fshatarëve. Lagja Lahaj dhe Hamza s'kanë as rrugë as kanalizime, ka fshat ska përfaqësues në Kuvend e që ne tani s'kemi një raport a është punuar. Mirëmbajtja e rrugëve lokale ku shkojnë këto mjetë, faqe 7 të arsimit në cilat shkolla ceken ata inventar, në cilat shkolla kabinete çfarë inventari në Shkollën "Labinot Krasniqi" në Mirushë ose printer dhe paisje tjera hyjnë në inventar, paisje informatike arsimtari i kësaj lende duhet të ketë kompjuter. Për shkollën në Gurëbardh a do të ndajë Komuna mjete, sepse 170 mijë ceket apo çka në vitin 2018 e 250 mijë vitin tjetër.

Hashim Vrezezi: Buxheti kish ndryshime në vite nga viti 2019 dhe 2020.

Rrahim Morina: Ka projekte dy vjeçare dhe ato sigurohen sipas viteve.

Hashim Vrezezi: Një kërkesë duhet bërë Drejtorisë se Financave ta precizojë çdo projekt sipas emrit të rrugëve ose të shtëpisë ku fillon projekti ose ku përfundon dhe të ketë një kopje te planit. Në Stapanicë ska emër te rrugës s'dihet ku ka mu investuar.

Rrahim Morina: Në çdo fshat janë emrat e rrugëve.

Alban Krasniqi: Këta qëllimisht e vonojnë veç ne me na qitë para aktit të kryer, drejtorët sot a kanë mirë me kanë prezent në mbledhje.

Rrahim Morina: Ne është mirë ta rekomandojmë për Kuvend e deri në mbledhje kemi mundësi me ba ndryshime.

Alban Krasniqi: Unë pa prezencën e Kryetarit dhe drejtorin s'jam me rekomanduar.

Rrahim Morina: Ne kemi mundësi me bërë edhe buxhetin alternativ në kuvend.

Alban Krasniqi: Të kemi në Kuvend informacione shtesë mos ta dërgojmë në kuvend pa sqarime, kisha thënë këtë javë ta mbajmë edhe një mbledhje të KPF, e me plotësuar këtë projekt buxhet.

Rrahim Morina: Në projektet e vitit 2018 mund të kërkojmë cilat kanë përfunduar dhe të specifikohen projektet për vitin 2019.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2019.

Hashim Vrenezi: Mirë është kësaj projekt rregullore meja bërë një modifikim, është mirë me bërë heqjen e taksave të bizneseve jo krejt por ato që janë të dëmshme ose jo shumë fitimprurëse. Në bibliotekë mirë është që lexuesit të kenë taksën zero kështu që te këtë lexim pa pagesë, sepse edhe ashtu sa taksa marrin kurrfarë efekti pozitiv nuk ka, te pjesa e bizneseve fq.8 -19.24, fq.9-19.32, 19.33,34,38,39,42, tjerat biznese mi hjekë se ky tatim prape përmes qeveris kthehet në Komunën tonë e ato po ngarkohen dyfish dhe nëse ne i hjekim këto taksa ne po u bëjmë me të lehtë të bërit biznes bile është mirë Komuna me nda buxhet për ato biznese sidomos për ato për ngritje te punësimit me punëtor.

Alban Krasniqi: Shumica e Komunave taksat i kanë me të larta se ne edhe nuk i kanë hjekë dhe nëse shikohet efekti i heqjes se taksave Nisma ka ardhur në pushtet me këtë perceptim. Bizneset e reja dhe shurja e të vjetrave shihet se po shuhet biznese dhe nuk po hapen të reja. Taksa nuk luan rol në qëndrueshmërinë e biznesit. Komuna përbehet prej qytetarëve dhe në rend të pare vjen qytetari, hajde të merremi me te ardhurat dhe të bëjmë dallimin sipas të ardhurave në tatim, ekziston pa barazi sepse ne ekzistojmë për qytetarin. Të synojmë buxhetin pa i hjekur taksat por me pa sa biznese janë, sa kanë të hyra dhe cila sferë e biznesit na duhet me shumë, sepse Nisma ka qef mi hjekë taksat.

Hashim Vrenezi: Si lidhmeri të bizneset është Inspektorati shembull të ekspozimi i mallrave jashtë lokaleve e që në pastaj i konsumojmë e ato duhet të inspektohen, sa biznese hapen e nuk gjenerojnë të hyra, sepse nëse ne e ngarkojmë biznesin aj e ngrit çmimin e me këtë ngarkohen qytetarët.

Rrahim Morina: Jam mi ndihmuar ata që jetojnë prej bizneseve e jo ndoshta një mjeku që për një vizite i merr 15 euro, e jo bizneseve me mallrat me afat të skaduar.

Raimonda Krasniqi: Një biznes që kemi në si familje dy herë në javë vet e dezinfektojmë lokalin e që bizneset tjera kanë edhe mallra me afat të skaduar edhe nuk kanë shumë kontrolle.

Valon Krasniqi: Në Bibliotekë taksa për regjistrim dhe lexim të jetë zero, në palestrën "Habib Zogaj" te hiqet taksa se ata edhe ashtu as shpenzimet e veta spo mund t'i nxjerrin.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend këtë projekt rregullore aty pastaj diskutojmë?

Unanimisht të gjithë ishin për rekomandim për Kuvend.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1319 datë: 14.09.2018 për iniciimin e procedurave administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllime të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe biznese private.

Rrahim Morina: Kryetari ka kërkuar përmes kësaj kërkesë me nda këtë pjesë e tani ndoshta me ja dhanë kujt të donë.

Hashim Vrenezi: Këtë kërkesë në start duhet ta refuzojmë si Komitet s'kemi çka me diskutua hiq.

Alban Krasniqi: Kërkesën kryetari e bien me dy faqe në Komitet pa ndonjë arsyetim, pa impakt ekonomik e biznesor s'jam me hy si kërkesë kështu.

Rrahim Morina: Kush jeni që me një përgjigje këtë kërkesë ta kthejmë te Kryetari i Komunës?

Unanimisht ishin për që t'i kthehet kërkesa me përgjigje kryetarit të Komunës.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për periudhën Janar-Shtator 2018.

Alban Krasniqi: Është për keqardhje kur vijmë këso raporte ceket disa sfida, por cilat janë ato nevoja, sa janë nevojat për fondin emergjent, çfarë personeli aty mungon, mungesa e logjistikes dhe me keqardhje pse nuk është i definuar statusi pra që qenka i pa zgjidhur.

Rrahim Morina: Kush jeni që te rekomandohet ky raport për Kuvend? Unanimisht ishin për.

6. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/333 datë: 10.09.2018 e parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirë të Luftës.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

7. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/334 datë: 10.09.2018 e parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidë, Veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe Martirë të Luftës.

Rrahim Morina: Kjo kërkesë ska shumë material këta kanë kërkuar një objekt për nevojat e tyre.

Alban Krasniqi: Jemi i vetmi vend që s'kemi vend ku të trajtohen rastet e veteranëve, 2 mijë Veteranë në Malishevë në një popullsi prej 60 mijë banorë. Këtu janë tash dy aspekte, shoqata ska sjellë dokumentacion sa

duhet ska as kopje të planit e ndoshta një palë kur banë kërkesë sjellë edhe me foto dokumentacionin, në aspektin ligjor kujt i ndahet vendi shoqatës apo Komuna ta ndërton. Mirë kish me qene ndoshta edhe Komiteti deri në mbledhje me sqaruar këtë kërkesë. Qëllimi ose karakteri duhet të jetë psikologjik, socializues etj.

Hashim Vrezezi: Mire kishte me qenë meju ba zgjidhje momentale.

Rahim Morina: Kush jeni që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

#### 8. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/322 datë:30.08.2018 e parashtruar nga Mehmet Krasniqi nga fshati Tërpezë .

Rahim Morina: Jam në njohuri për këtë kërkesë sepse parashtruesi thotë se ja kanë ndërruar emrim e një rruge.

Raimonda Krasniqi: Behët fjalë për një rrugë që shkon për në fshatin e Ri dhe ndahet, pastaj në dy rrugë e njëra ndër to është kjo që kërkohet te emërtohet me emrin e Dëshmorit Afrim Krasniqi.

Rahim Morina: Kur janë shqyrtuar emrat e rrugëve familja ka pajtuar të jetë emri i asaj rrugë Afrim Krasniqi se me tre emra Agjencioni nuk ka pranuar.

Kërkesa nr.02/304 të datës: 23.08.2018 e parashtruar nga Shaqir Morina nga fshati Lumishtë.

Rahim Morina: Ky po kërkon një rrugë meja ngjit emrin e babës sepse kjo rrugë e ka emrin e një mësuesi.

Pa qenë komisioni ne këto kërkesa individuale nuk mundemi mi trajtuar kështu, prandaj duhet me ja kthye një përgjigje se kur te formohet komisioni i shqyrtton të gjitha kërkesat.

Hashim Vrezezi: Kur ngjiten tabelat me emrat e rrugëve duhet të jenë të pranueshme e jo pastaj qytetaret me dal mi hjekë.

Alban Krasniqi: Ajo kërkesa e parë që ja kanë ndërruar emrin shihet se është legjitime, kjo e dyta duhet të refuzohet.

Rahim Morina: Ne kur kemi punuar si komision për emërtimin e rrugëve kemi pas telashe nëper disa fshatra.

Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend kërkesën nr. 02/322 datë:30.08.2018 e parashtruar nga Mehmet Krasniqi nga fshati Tërpezë? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.09/427 datë:18.09.2018 e parashtruar nga Osman Robaj nga fshati Astrazup për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësorë në tokë ndërtimore.

Alban Krasniqi: Kur kemi këso kërkesa drejtorët duhet me ardhe me një arsyeshmëri.

Rahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend këtë kërkesë? Unanimisht ishin për.

#### 9. Të ndryshme

Alban Krasniqi: Kërkoj të dijë çka a bërë më rregulloren për tokën bujqësore.

Rahim Morina: Unë kam biseduar me Kryetarin aj ka kërkuar nga Drejtoria me paraqite në debat publik, prapë do të kërkoj. Edhe për Komisionin e Aksionarëve kam kërkuar nga Ministria dhe prapë do të kërkoj se ende nuk me kanë dhënë ndonjë përgjigje.

Hashim Vrezezi: Kur ta përpiloni rendin e ditës kryesues piken 9 vendoseni si 2, pikën 10 vendoseni pikë 3, pikën 8 në pikë 4 e tjerat mundi t'i vazhdoni.

Rahim Morina: Nëse dikush nuk ka diçka atëherë ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 12.10 min.

Procesmbajtësi:

Naim Avdijaj jur. i dip

